REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot. Tiranë, më ___ .___. 2026

RELACION
MBI PROJEKTVENDIMIN "PËR MIRATIMIN E STUDIMIT PËR RISHIKIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË GJYQTARËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

I. Detyrimi ligjor për nxjerrjen e aktit

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147, dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 21 dhe 22 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është organi përgjegjës për propozimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, bashkë me propozimin për buxhetin e sistemit gjyqësor, sipas procedurës së caktuar me ligj.

Në ushtrim të kësaj kompetence, Këshilli synon të garantojë një shpërndarje të ekuilibruar të ngarkesës së punës ndërmjet gjyqtarëve dhe gjykatave, në funksion të administrimit efikas të drejtësisë. Për këtë qëllim, Këshilli monitoron ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe veprimtarinë e gjykatave, duke vlerësuar nevojën për rishikimin e numrit të gjyqtarëve në përputhje me nevojat e sistemit gjyqësor dhe kriteret e përcaktuara nga legjislacioni.

Nevoja për hartimin e këtij studimi lidhet gjithashtu me zbatimin e Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027, miratuar me vendimin nr. 407, datë 15.07.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në kuadër të Objektivit 1.1 të këtij Udhërrëfyesi, "*Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministrimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore*", ndër masat e parashikuara për adresimin e nevojave për burime njerëzore në sistemin gjyqësor, përfshirë trupën gjyqësore dhe stafin jogjyqësor, përcaktohet edhe hartimi dhe prezantimi i një analize mbi nevojën për rishikimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve, në përputhje me metodologjinë e CEPEJ-it.

Për këtë qëllim, me urdhrin nr. 195, datë 24.12.2025, të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u ngrit grupi i punës "Për rishikimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve", i përbërë nga anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe përfaqësues të administratës së tij. Në veprimtarinë e këtij grupi pune, një kontribut të rëndësishëm ka dhënë edhe Këshilli i

Evropës, nëpërmjet asistencës së ofruar nga ekspertët e tij, duke mbështetur procesin e analizës dhe vlerësimit të nevojave për rishikimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve.

II. Natyra e aktit dhe harmonizimi i tij me kuadrin ligjor ekzistues

Projektakti që i paraqitet për miratim Këshillit të Lartë Gjyqësor synon formalizimin e studimit për rishikimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër, neni 21 i ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton fazat procedurale që duhet të ndiqen deri në marrjen e vendimit përfundimtar për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve.

Miratimi i këtij akti nga Këshilli shënon përmbylljen e fazës fillestare të analizës dhe vlerësimit të nevojave të sistemit gjyqësor dhe krijon bazën për vijimin e procedurës, nëpërmjet marrjes së mendimeve nga Këshillat e Gjykatave, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave, si dhe zhvillimit të konsultimit me palët e tjera të interesuara, në përputhje me parashikimet e ligjit "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

III. Komente të përgjithshme mbi aktin

Në kuadër të nevojës për vlerësimin dhe planifikimin e kapaciteteve njerëzore të sistemit gjyqësor, studimi i përgatitur synon të evidentojë nevojat për rritjen e kapaciteteve gjyqësore, në funksion të përballimit të fluksit të çështjeve, parandalimit të krijimit të stokut të ri dhe reduktimit gradual të çështjeve të prapambetura. Përcaktimi i numrit të propozuar të gjyqtarëve, është kryer bazuar në analizën e periudhës 2023-2025 dhe nuk mbështetet vetëm në raportin ndërmjet numrit të çështjeve dhe numrit të gjyqtarëve, por në një vlerësim të kombinuar të disa treguesve, ndër të cilët:

- fluksi mesatar vjetor i çështjeve dhe produktiviteti i gjyqtarëve;
- stoku i çështjeve të papërfunduara dhe vjetërsia e tyre;
- raporti ndërmjet çështjeve të përfunduara dhe atyre të ardhura (Clearance Rate);
- koha teorike e nevojshme për përpunimin e stokut (Disposition Time);
- kapaciteti real gjykues, i shprehur në FTE;
- kompleksiteti i çështjeve, nevojat për formimin e trupave gjykues dhe mbulimi territorial;
- raportet e personelit jogjyqtar dhe kushtet infrastrukturore të gjykatave.

Ndërsa krahasimi demografik dhe treguesit europianë përdoren si instrument kontrolli të arsyeshmërisë së rezultatit, dhe jo si standard mekanik për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve.

Struktura aktuale e sistemit gjyqësor përbëhet aktualisht nga 417 gjyqtarë, referuar vendimit nr. 233, datë 23.04.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nga 417 vende të miratuara, rezultojnë 343 gjyqtarë në organikën faktike dhe 309 gjyqtarë efektivisht në detyrë. Diferenca

prej 108 gjyqtarësh ndërmjet strukturës së miratuar dhe kapacitetit efektiv përbëhet nga 74 vende të lira dhe 34 njësi ekuivalente me kohë të plotë (FTE) të padisponueshme për shkak të angazhimeve ose mungesave funksionale. Ky dallim është i rëndësishëm për përcaktimin e masave që duhen ndërmarrë, pasi plotësimi i vendeve ekzistuese dhe kompensimi i kapaciteteve të humbura funksionalisht përbëjnë procese të veçanta nga rritja e organikës.

Në këto kushte, studimi vlerëson se plotësimi i vakancave ekzistuese, ndonëse i domosdoshëm, nuk mjafton për të garantuar një kapacitet të qëndrueshëm gjykues. Për këtë arsye, propozohet një ndërhyrje strukturore, e mbështetur në analizën e ngarkesës, stokut të çështjeve, produktivitetit, kohëzgjatjes së përpunimit dhe nevojave organizative të gjykatave.

Në përfundim të analizës, studimi propozon rishikimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve për periudhën 2026–2030, nëpërmjet disa masave të detajuara në vijim.

IV. Propozimet e studimit mbi rishikimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve

1. Miratimi i 84 vendeve operacionale të përhershme.

Studimi propozon shtimin e 84 vendeve të përhershme për gjyqtarë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit, nga të cilat 64 vende pranë gjykatave të shkallës së parë dhe 20 vende pranë gjykatave të apelit.

Për gjykatat e shkallës së parë nga 64 vende në total propozohet që 44 prej tyre të shkojnë për për juridiksionin e përgjithshëm, konkretisht 18 në Tiranë, 6 në Durrës, 5 në Elbasan, 6 në Fier, 3 në Korçë, 3 në Shkodër dhe 3 në Vlorë. Për juridiksionin administrativ propozohet shtimi me 18 vende, ku 16 i caktohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe 2 Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje. Ndërsa në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar propozohet shtimi me 2 vende.

Për gjykatat e apelit nga 20 vende të total propozohet që, 6 prej tyre të shkojnë për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 12 për Gjykatën Administrative të Apelit dhe 2 për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Me miratimin e kësaj shtese organika rritet nga 417 në 501, para llogaritjes së rezervës funksionale.

Megjithatë, studimi propozon që shtimi i 84 pozicioneve të përhershme për gjyqtarë të zbatohet me faza deri në vitin 2030, duke e lidhur aktivizimin vjetor të tyre me prurjet nga Shkolla e Magjistraturës, procedurat e ngritjes në detyrë dhe mundësitë buxhetore. Përpara çdo cikli emërimesh, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të rishikojë dhe të rikonfirmojë prioritetet, në përputhje me ndryshimet në fluksin e çështjeve dhe nevojat e gjykatave.

Pozicionet e paaktivizuara nuk duhet të shpërndahen automatikisht, ndërsa për ato që tejkalojnë ndjeshëm rezultatin e formulës së vlerësimit duhet të kërkohet një vendimmarrje e veçantë për aktivizimin, e mbështetur në të dhënat e vitit pararendës. Kjo qasje ruan karakterin e përhershëm të pozicioneve në organikë, duke garantuar njëkohësisht që aktivizimi i tyre të jetë gradual, i argumentuar dhe në përputhje me nevojat reale të sistemit gjyqësor dhe kapacitetet buxhetore.

2. **Krijimi i 18 vendeve të përhershme të rezervës funksionale.**

Përveç 84 vendeve të përhershme operacionale, propozohet edhe krijimi i 18 vendeve të përhershme të rezervës funksionale. Rezerva funksionale synon të kompensojë humbjen efektive të kapaciteteve gjyqësore në rastet kur gjyqtarët angazhohen për periudha të gjata në institucione të tjera, pa u krijuar vakancë formale në gjykatën e origjinës.

Rezerva propozohet të ndahet fillimisht në 10 pozicione për gjykatat e shkallës së parë dhe 8 për gjykatat e apelit, duke u aktivizuar vetëm në masën që justifikohet nga mungesat e dokumentuara në ekuivalentin e kohës së plotë të punës (FTE). Studimi propozon që rezerva të rishikohet të paktën një herë në vit, ndërsa pozicionet e pambështetura nga nevoja faktike mbeten të paaktivizuara. Çdo rishpërndarje duhet të respektojë garancitë ligjore që lidhen me statusin e gjyqtarëve, përfshirë palëvizshmërinë dhe pëlqimin kur kërkohet.

Me realizimin e këtyre dy shtesave, numri i vendeve të përhershme të gjyqtarëve parashikohet të rritet nga 417 në 519.

3. **Kapacitet i përkohshëm prej 9 gjyqtarësh në Gjykatën e Lartë.**

Studimi evidenton nevojën për një kapacitet shtesë prej 9 gjyqtarësh në Gjykatën e Lartë, për një mandat të vetëm, të parinovueshëm dhe të lidhur me trajtimin e një kategorie të përcaktuar çështjesh. Kjo masë synon të kontribuojë në reduktimin e stokut të akumuluar në këtë gjykatë.

Megjithatë, aktivizimi i saj kërkon vlerësim të posaçëm kushtetues dhe ligjor, si dhe krijimin e bazës normative të nevojshme. Për rrjedhojë, miratimi i nevojës funksionale nuk përbën autorizim për emërim të menjëhershëm jashtë procedurave dhe garancive të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji. Në rast se mekanizmi i propozuar nuk rezulton juridikisht i mundur, studimi parashikon shqyrtimin e një zgjidhjeje ekuivalente, të lejuar nga kuadri kushtetues dhe ligjor.

Përveç masave të mësipërme, studimi parashikon monitorimin tre mujor mbi plotësimin e vakancave dhe rishikimin vjetor të kapaciteteve gjyqësore, bazuar në treguesit e ngarkesës, produktivitetit dhe plotësimit të vakancave, si dhe përshtatjen e shpërndarjes dhe aktivizimit të pozicioneve sipas nevojave reale të gjykatave. Gjithashtu, në fund të vitit 2030

parashikohet një vlerësim i përgjithshëm i efektivitetit të masave dhe përshtatshmërisë së organikës, për të orientuar planifikimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore në sistemin gjyqësor.

4. Rritja e kapaciteteve të administratës gjyqësore

Studimi nënvizon se shtimi i numrit të gjyqtarëve duhet të shoqërohet me rritjen përkatëse të personelit jogjyqtar, në mënyrë që kapaciteti i ri të jetë funksional dhe të prodhojë rezultatet e synuara. Në bazë të raporteve të personelit sipas niveleve të gjykimit, propozohet një minimum planifikimi prej 336 punonjësish jogjyqtarë për 102 vendet e përhershme, si dhe 56 punonjës për paketën e përkohshme prej 9 gjyqtarësh në Gjykatën e Lartë.

Gjithashtu, studimi thekson se shtimi i pozicioneve të reja duhet të shoqërohet me sigurimin e infrastrukturës së nevojshme ndërtimore dhe teknologjike të nevojshme për funksionimin efektiv të gjykatave. Për këtë qëllim, rekomandohet hartimi i një plani të posaçëm investimesh.

Zbatimi rekomandohet të kryhet me faza gjatë periudhës 2027–2030 dhe të lidhet me katër kushte të pandashme: i.) sigurimin e kandidatëve, ii.) personelin mbështetës, iii.) financimin buxhetor dhe iv.) gatishmërinë infrastrukturore, duke i dhënë përparësi gjykatave me Clearance Rate nën 100%, stok të lartë dhe çështje me vjetërsi mbi tre dhe pesë vjet.

V. Efektet financiare të propozimit për shtesën e numrit të gjyqtarëve dhe shtesë të stafit administrativ gjyqësor

Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka realizuar një përllogaritje të përafërt të efektit financiar, që vjen nga rritja e numrit të gjyqtarëve, me 102 vende të përhershme e cila duhet të shoqërohet domosdoshmërisht me shtimin e administratës gjyqësore, së paku me 336 punonjës jogjyqtarë, e cila konsiston se ka një efekt financiar për një vit buxhetor, në shpenzime personeli në shumën prej **424,000 mijë lekë** për 102 gjyqtarë dhe në shumën prej **656,000 mijë lekë** për 336 punonjës jogjyqtarë (nga të cilët 102 ndihmës ligjore dhe 234 nëpunës civil gjyqësor).

Ndërsa paketa e përkohshme prej 9 gjyqtarësh në Gjykatën e Lartë, e cila kërkon rreth 56 punonjës shtesë, ka një efekt financiar në shpenzime personeli në shumën prej **48,000 mijë lekë** për 9 gjyqtarë dhe në shumën prej **93,000 mijë lekë** për 56 punonjës jogjyqtarë (nëpunës civil gjyqësor).

Pra, efekt financiar për një vit buxhetor, të propozimit për shtesë të numrit gjyqtarëve dhe shtesë stafit administrativ gjyqësor, në shpenzime personeli përllogaritet përafërsisht, në shumën prej **1,220,000 mijë lekë**

VI. Struktura e projektvendimit

Në pikën e parë parashikohet miratimi i studimit për rishikimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, i cili do të jetë pjesë përbërëse e vendimit.

Në pikën e dytë parshikohet përcjellja e studimit, pas miratimit, Këshillave të Gjykatës, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave për marrjen e mendimit mbi propozimet e paraqitura në të.

Në pikën e tretë parashikohet konsultimi me palë të tjera të interesuara, sipas rregullave të parashikuara në ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Në përfundim parashikohet hyrja në fuqi menjëherë pas miratimit nga mbledhja plenare dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

GRUPI I PUNËS PËR RISHIKIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË GJYQTARËVE